

PROCESVERBAL-Tipi I kontratës-PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndertim i Ujesjellesit per fshatrat, Rrodokal i poshtem,Rrodokal i siperm, Homezh, Homcan

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV):

45247130-0 punime ndërtimi për ujësjellës

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 222 211 280 (dyqind e njezet e dy milion e dyqind e njembedhjete mije e dyqind e tetedhjet) leke pa tvsh(financim sipas planit buxhetor)

Argumentimi: Fondi limit i procedurës është përcaktuar mbi bazën e preventivit të hartuar nga projektuesi i autorizuar, i cili përmban analizën e detajuar të volumeve të punimeve, çmimeve njësi dhe kostove përkatëse për realizimin e objektit të kontratës. Preventivi është përgatitur në përputhje me projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike të miratuara.

Në zbatim të nenit 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe rregullave të parashikuara në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti kontraktor ka përlllogaritur vlerën e parashikuar të kontratës mbi bazën e një analize reale dhe të dokumentuar të kostos së punimeve. Për këtë arsye, fondi limit është mbështetur në preventivin e projektuesit, i cili përfaqëson vlerësimin teknik dhe ekonomik të nevojshëm për realizimin e plotë të objektit të prokurimit, duke garantuar përdorimin me eficiencë të fondeve publike dhe zhvillimin e një procedure konkurruese.

Preventivi i hartuar nga projektuesi përfshin zërat e punimeve, sasi të, analizat teknike dhe çmimet përkatëse, të cilat janë bazuar në metodologjinë e hartimit të preventivave të punimeve të ndërtimit dhe përbëjnë bazën objektive për përcaktimin e fondit limit të procedurës së prokurimit. Kjo metodë siguron që fondi limit të jetë i argumentuar teknikisht, ekonomikisht dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentim I Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor, në zbatim të nenit 87 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, ka vendosur që oferta fituese të identifikohet sipas metodës **“Oferta e bazuar në kosto”**, duke u mbështetur në raportin më të mirë **cilësi–çmim**, pasi objekti i kontratës **“Ndertim i Ujesjellesit per fshatrat, Rrodokal i poshtem, Rrodokal i siperm, Homezh, Homcan.**

” është një investim publik kompleks, ku cilësia e realizimit ndikon drejtpërdrejt në funksionalitetin, jetëgjatësinë dhe kostot e operimit të sistemit.

Përzgjedhja vetëm mbi bazën e çmimit më të ulët nuk garanton domosdoshmërisht realizimin e një infrastrukture me standardet e kërkuara teknike dhe funksionale. Në investimet e ujësjellësit, rëndësi të veçantë kanë organizimi i punimeve, mobilizimi në kantier, aftësia organizative e operatorit ekonomik, masat për mbrojtjen e mjedisit dhe garancia e punimeve, pasi këta elementë ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e veprës dhe në reduktimin e kostove gjatë ciklit të jetës së saj.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se është në interes publik të mos mbështetet ekskluzivisht në çmim, por të vlerësojë edhe elementët cilësorë që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës, konkretisht:

Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit (20 pikë), pasi organizimi dhe mobilizimi i shpejtë ndikojnë në respektimin e afateve kontraktore, minimizimin e ndërprerjeve të furnizimit me ujë dhe uljen e kostove indirekte gjatë zbatimit.

Stafi dhe organizimi i kompanisë (15 pikë), pasi një strukturë organizative e mirë garanton menaxhim efektiv të punimeve, koordinim të proceseve dhe kontroll më të mirë të cilësisë.

Masat për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimit social (10 pikë), duke qenë se punimet e ujësjellësit zhvillohen në zona të banuara dhe shoqërohen me gërmime, ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese dhe ndikime të përkohshme mbi komunitetin. Vlerësimi i këtyre masave është në përputhje me nenin 87 të ligjit, i cili lejon përdorimin e kriterëve mjedisore dhe sociale.

Periudha e garancisë (5 pikë), pasi një garanci më e gjatë rrit sigurinë e Autoritetit Kontraktor për cilësinë e punimeve dhe ul rrezikun e shpenzimeve shtesë pas marrjes në dorëzim të objektit.

Pesha prej **50 pikësh për çmimin** dëshmon se elementi ekonomik mbetet faktori kryesor në vlerësim, ndërsa **50 pikët e mbetura** u kushtohen elementëve teknikë dhe cilësorë që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e kontratës. Kjo shpërndarje është proporcionale me natyrën e investimit dhe synon identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, duke garantuar përdorimin me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo metodë realizon në mënyrë më të plotë parimet e barazisë, transparencës, proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme, si dhe siguron zgjedhjen e operatorit ekonomik që ofron jo vetëm çmimin më konkurrues, por edhe garancinë më të mirë për realizimin me cilësi të investimit publik.

Së pari në DST **Kapitulli 4.4** “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” Autoriteti Kontraktor gjykoj që të vlerësohet mbi bazën e Ofertës ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ x

Sipas rëndësisë:

Çmimi □	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit □ □	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanise □ □	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □ □	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit □ □	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b, 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 22 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

- a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]
- I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 30 dite) [2 pike].
- II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k2a}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k2a}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2a}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Kualifikimi I stafit Kyc dhe eksperiencia ne fushen specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas percaktimeve me poshte:

I. Deshmi që stafi disponon diplome universitare [6 pike]

II. Deshmi që stafi disponon pune të ngjashme me objektin e prokurimit [4 pike]

III. Deshmi që stafi disponon experience mbi 1(nje) vit pune [2 pike]

IV. Deshmi që stafi disponon eksperience ne natyre/kompleksitet te ngjashme me kontraten e prokurimit. [1 pike]

Per permbushjen e kritereve te mesiperme duhet te dorezohet CV dhe deshmi/reference/dokumentacion te leshuar nga punedhenes te meparshem ose perfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

*Shënim: Per permbushjen e kriterit te mesiperme operatori ekonomik duhet te dorezoje organigramen e propozuar te stafit qe do te operoje ne ekzekutimin e kontrates, metodologjise te nderveprimit midis strukturave me njera-tjetren, me mbikeqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh perbejne sistemet e brendshme te kontrollit dhe menaxhimit te cilesise.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k5}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k5}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2.Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos,duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, nëpërputhje me nenin 88 të këtij ligji,**dhe mund të bazohet në raportin më të mire çmim-cilësi**,që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë,**duke përfshirë cilësinë ,aspektet mjedisore dhe/ose social**

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a)**cilësinë**,duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit ,karakteristikat mjedisore dhe novatore,si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b)**organizimin,kualifikimin dhe përvojën e stafit** që është emëruar për të zbatuar kontratën,kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës;ose

c)shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike,kushtet e dorëzimit,si,përshebull,datën e dorëzimit,procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos,gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm përkriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët,furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo faze të ciklit të tyre jetësor,duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a)procesin specifik të prodhimit,ofrimit ose tregtimit të atyre punëve,furnizimeve ose shërbimeve, ose

b)një process specifik,për një faze tjetër të ciklit të tyre jetësor,edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

5.Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit ***shkallën e rëndësisë relative që I jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme***,me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Me qëllim garantimin jo vetëm të çmimit më të ulët, por edhe të cilësisë së realizimit të kontratës, organizimit teknik, afateve të zbatimit dhe qëndrueshmërisë së punimeve.

Kriteret e përdorura janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synojnë identifikimin e operatorit ekonomik që garanton realizim sa më cilësor, efikas dhe në kohë të punimeve.

Ndarja e pikëve është bërë mbi bazën e rëndësisë që secili element ka në realizimin me sukses të kontratës, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit.

2.Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit – 20 pikë

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e operatorit ekonomik për të organizuar dhe realizuar kontratën brenda afateve të kërkuara.

Vlerësimi i grafikut të punimeve dhe kohës së mobilizimit synon:

- shmangien e vonesave në ekzekutimin e kontratës;
- garantimin e fillimit të menjëhershëm të punimeve;
- sigurimin e një planifikimi realist dhe teknikisht të zbatueshëm.

Pesha prej 20 pikësh konsiderohet proporcionale për shkak se organizimi i punimeve dhe mobilizimi ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e kontratës dhe në interesin publik.

Autoriteti Kontraktor shpalli kërkesën për Grafikun e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar përkëtë kriter **20 pikë**,duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin me sukses të cdo vepre,pasi duke ndërthurur elementin cilësi,saktësi dhe precision në kryerjen e punimeve,por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit,inxhinierë,teknikë,specialistë,punëtorë të thjeshtë,ndihmësetj,mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor **por dhe njëherësh me cilësinë e duhur**,duke I dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të plotë të operatorit ekonomik pjesëmarrës I cili në përfundim do të sjellë rezultate te kërkuara dhe të pritura nga ky autoritet.

Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës.Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike)kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

3. Stafi / Organizimi i kompanisë – 15 pikë

Ky kriter vlerëson strukturën organizative dhe kapacitetet njerëzore që operatori ekonomik do të angazhojë për realizimin e kontratës.

Qëllimi është të garantohet se:

- kontrata do të realizohet nga personel i kualifikuar;
- ekziston organizim i qartë teknik dhe administrativ;
- operatori ka kapacitete reale për menaxhimin e punimeve.

Pesha prej 15 pikësh është proporcionale me rëndësinë që ka faktori njerëzor në cilësinë dhe sigurinë e realizimit të kontratës.**Stafi/Organizimi i Kompanise,I cili vlerësohet deri në 15pikë**,duke ditur që vetëm një staf I kualifikuar profesional inxhiniero-teknik dhe me përvojën e duhur mund të sjellë rezultate te dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit.Një operator ekonomik I cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilësi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projek preventivit të parashikuar nga autoriteti kontraktor.Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me **përvojë/experience** të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

Disa nga nën kriteret janë **kualifikimi I stafit Kyc dhe eksperiencia ne fushen specifike** i cili provohet me dokumentacionin përkatës. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe **skemën e organizimit të stafit** të propozuar për realizimin e kontratës, organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social – 10 pikë

Ky kriter mbështetet në parimet e prokurimit të qëndrueshëm dhe synon nxitjen e praktikave që minimizojnë ndikimin negativ në mjedis dhe komunitet gjatë zbatimit të kontratës. Vlerësimi mund të lidhet me:

- menaxhimin e mbetjeve;
- reduktimin e ndotjes akustike dhe pluhurave;
- masat për sigurinë publike;
- organizimin e qarkullimit dhe minimizimin e ndikimit social.

Pesha prej 10 pikësh është në raport të drejtë me rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit dhe interesit publik gjatë realizimit të punimeve.

Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që ne me veprimet apo mosveprimet tona ndikojmë në mjedis dhe në komunitetin tone të përbashkët pozitivisht/negativisht.

Duke patur parasysh se përveç realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe **parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi I ndikimeve negative ndaj mjedisit.**

Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një vepre mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër të tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm I gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi I të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, florë dhe faunë, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj.

Në veçanti duhet t'i kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi I procedurave, normave, standarteve dhe planifikime të paraqitura në projekt gjatë realizimit të tij si dhe **të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.**

Për të gjitha këto elemente operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe të detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë **Propozime konkrete** sesi do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të çdo operatori ekonomik ofertues.

Nënkriteret për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave I Autoritetit Kontraktor, do të jenë:

1. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin)/të ricikluara/efiçente/ material që minimizojnë ndikimin mjedisor.Përdorimi i makinerive/pajisjeve ekologjike.Hartimi I një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore.
2. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë locale të zones ku zhvillohet projecti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve.

5. Periudha e garancisë së objektit – 5 pikë

Periudha e garancisë vlerësohet si element që lidhet me qëndrueshmërinë dhe cilësinë afatgjatë të punimeve.

Dhënia e pikëve për një periudhë garancie më të favorshme synon:

- sigurimin e cilësisë së punimeve;
- reduktimin e riskut për defekte pas përfundimit të kontratës;
- rritjen e përgjegjshmërisë së operatorit ekonomik.

.

Një rëndësie te vecantë I është dhënë edhe **Periudhës së garancisë së objektit** e cila tregon jetëgjatësinë e objektit, faktin se sa më maksimale të jetë **periudha që përfshin garancinë e veprës**, e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq më tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final **realizimin përfundimtar të veprës dhe marrjen në dorëzim të saj.**

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:

- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3 të Kapacitetit teknik , të shtojcës 7, të DT;
- Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik , të shtojcës 7, të DT
- Stafi inxhinierik (drejtues teknik) kërkuar sipas pikës 2.3.5 b), të Kapacitetit teknik të shtojcës 7, të DT.

Argumentimi :

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi përvoja për të zbatuar kontratën, licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh dhe stafi inxhinierik (drejtuesit teknik) vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen te AK se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standardeve të kërkuara.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2.2Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare si me poshtë :

2.2.1 Kopje te certifikuara te balanceve te tre viteve te fundit 2023,2024,2025 te konfirmuara me vule prane administrates tatimore. te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël””.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2023,2024,2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera 222 211 280 (dyqind e njezet e dy milion e dyqind e njemdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) leke pa tvsh e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77, pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik ku përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në :b) **gjendjen ekonomike dhe financiare ; ... 3)Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”**

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Përmiratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “Autoritetit kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3(tre) vitet e fundit financiare.**”

Ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera 222 211 280 (dyqind e njezet e dy milion e dyqind e njembedhjete mije e dyqind e tetedhjet) leke pa tvsh e fondit limit të kontratës që prokurohet.

:...b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Nëse vlerësohet, Autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vite të fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Gjithashtu, për caktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili percakton “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar nëudhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancinkontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar pika 3.12 etij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr.25 datë 10.05.2018** “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 9 i tij ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përgjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financa”.

Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” gjykojmë që të kërkojmë xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021,2022,2023) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Komisioni përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe kestet e matuara për vitin 2026 lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024, 2025 pranë bashkisë/vendit ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

U përcaktuan kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Njesia e prokurimit

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 88 884 512 (tetedhjet e tete milion e teteqind e tetedhjet e kater mije e peseqind e dymbëdhjete) 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se vlera 222 211 280 (dyqind e njezet e dy milion e dyqind e njemëdhjete mije e dyqind e tetedhjet) leke pa tvsh limit e kontrates qe prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore,
- Aktin e kolaudit;

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
- Formular Vlerësimi

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik”ku përcaktohet se:“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale,autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burime te nevojshme njerëzore e teknike,si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Autoritetet ose entet kontraktore,në veçanti,mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një.Nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**”

Në nenin 39“Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,të ndryshuar ku përcaktohet se:“Për të provuar përvojën e mëparshme,autoriteti/enti kontraktor kërkon:**a)punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit,nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;b)punë të ngjashme deri në një kufi,ku vlera monetare totale e punëve të kryera,e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit,është jo më e madhe se dyfishi I vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi I njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/entikontraktor,si dëshmi për përvojën e mëparshme,kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik,për përmbushjen me sukses të kontratës,ku të shënohen vlera,afati I përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti /enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime,për përmbushjen me sukses të kontratës,ku të shënohen vlera,afati I përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë,e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi ,që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor,përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë

kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat I vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Autoriteti Kontaktor përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. **Përvoja te mëparshme** janë element shumë i nevojshëm, që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën mes sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriterii kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë më përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e më parshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët të jenë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situata të mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedurë.

Referuar këtij neni, AK vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (I ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin edhe situacionet përfundimtare dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punime të mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zëra të punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punime të mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), A K gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Ndërsa me ndryshime të reja ligjore përkatësisht VKM Nr. 498, datë 01.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, Neni 16 ku parashikohet “Në paragrafin e fundit, të pikës 5, të nenit 39, “Kërkesatë veçanta për kontratat për punë publike”, pas fjalëve “..., e shoqëruar me fatura tatimore...” shtohen “... të deklaruara në organet tatimore...” u kërkuar që në kërkesën e bërë për punime të ngjashme të kryera dhe të realizuara me sektorin privat: si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, të paraqiten vërtetime të shoqëruara me faturat tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat, natyra e punës së kryer dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë profesionale të shoqërisë, te vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- Kategoria NP- 1 Punime germimi ne toke Klasifikimi C
- Kategoria NP- 2 Ndërtime civile dhe industriale Klasifikimi C
- Kategoria NP- 7 Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje Klasifikimi E
- Kategoria NS – 4 Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese Klasifikimi A
- Kategoria NS–14 Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TVetj Kategoria A

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipaslegjislationit ne fuqi.

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 39, pika 6/a, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Liçencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Në nenin 39“Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr.285 datë19.05.2021“Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/entikontraktorkërkon:a)**licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekti kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr.42 datë16.01.2008 e ndryshuar“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedura të dhënies së licencave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike,që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”(lidhja2,3dhe4).Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate,në mbështetje të Ligjit Nr.8402datë10.09.1998“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar),si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike,që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”,AK vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licensën profesionale për zbatim të punimeve,kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve,si dhe klasifikimin në nivele të kërkuara për çdo kategori punimesh,kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës.Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre,sipas kategorive dhe niveleve (gërmave)përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respective dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për kë të objekt.

Niveli i klasifikimit për kategoritë respective është kërkuar duke u bazuar në zëra të punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara nëVKM Nr.42date16.01.2008,të ndryshuar.si me poshte :

Kategoritë e licencave me sipër teknikisht argumentohet:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes</i>	<i>Zerat e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv qe përfshihen ne kategorine perkatese</i>	<i>Niveli i klasifikimit te kërkuar per kategorine respektive</i>	<i>Vlera e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe përfshihen ne kategorine perkatese</i>
NP- 1	Punime gërmimi në tokë	1.Punime Germimi 2.Punime Dheu 6.Punime Shtresash 2 Etj...	C	Nuk e kalon vleren 100 milion
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	4.Punime Betoni e Betonarmeje 5.Punime Hekur Betoni 7.Punime Hidroizolimi dhe Catie 9.Punime Ngritje Kantjeri 7.Analiza teknike per punimet dhe instalimet teknologjike 11.Prodhim i materialeve te ndertimit 17.Analiza jashte liste 17 Punime murature tulle 3.Punime shtresash 2 Etj....	C	Nuk e kalon vleren 100 milion

NP-7	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje”	3.Ndertimi i veprave te artit + Kanalizime 8.Instalime Hidro-Sanitare dhe ngrohje 10.Gaz e Naftesjelles 12.Analiza jashte liste 13.Punime Ajrimi (Ventilimi) 16.Ujesjelles e Kanalizim i jashtem Etj...	E	Nuk e kalon vleren 400 milion
NS – 4	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese	9.Punime Hidroizolimi dhe Catie 10.Punime Dyer Dritare 11.Punime Bojatisje 12.Punime tavani dhe suvatimi 12.Punime Bojatisje Etj...	A	Nuk e kalon vleren 20 milion
NS-14	Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TVetj	7. Analiza teknike per punimet dhe instalimet teknologjike	A	Nuk e kalon vleren 20 milion

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikatat te vlefshme si me poshte:

- SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001:2015 (SSH/DIN/EN/UNI ISO 14001-2026)** e përditësuar, (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)**ose ekuivalent**
- SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** (Sistemi i menaxhimit te cilesise)**ose ekuivalent**
- SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2023** (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**ose ekuivalent**
- SSH/DIN/EN/UNI **ISO 39001:2012** (Sistemi i menaxhimit te sigurise rrugore) **ose ekuivalent**.

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe.Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatoresh, certifikatat duhet te jene ne perputhje me punimet e marra persiper.

Argumentimi: Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

- **ISO 14001:2015 / 14001:2026 – Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit**

Punimet për ndërtimin e ujësjellësit përfshijnë gërmime, transport inertesh, përdorim makinerish të rënda, menaxhim të mbetjeve të ndërtimit dhe ndërhyrje në mjedis. Prandaj, operatori ekonomik duhet të disponojë një sistem të menaxhimit mjedisor që garanton identifikimin, kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative në mjedis gjatë zbatimit të kontratës.

Kjo certifikatë siguron që operatori:

- menaxhon mbetjet sipas legjislacionit në fuqi;
- parandalon ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit;
- respekton kërkesat ligjore mjedisore;
- zbaton masa për rehabilitimin e zonave të prekura nga punimet.

- **ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë**

Ndërtimi i një rrjeti ujësjellësi kërkon zbatim të standardeve teknike në çdo fazë të punimeve, duke filluar nga furnizimi me materiale, montimi i tubacioneve, kryerja e provave hidraulike dhe dorëzimi i vepërës.

Disponimi i ISO 9001 garanton që operatori ekonomik:

- zbaton procedura të kontrollit të cilësisë;
- siguron gjurmueshmërinë e materialeve;
- monitoron proceset e punës;
- redukton rrezikun e defekteve dhe ripunimeve;
- garanton realizimin e punimeve sipas projektit dhe specifikimeve teknike.

Kjo certifikatë ndihmon autoritetin kontraktor të sigurojë që objekti do të realizohet me cilësi dhe në përputhje me standardet teknike.

- **ISO 45001:2023 – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë**

Punimet e ndërtimit të ujësjellësit konsiderohen punime me rrezik të shtuar, pasi përfshijnë gërmime të thella, punime në kanale, përdorim makinerish të rënda, ngritje materialesh dhe punë pranë rrjeteve ekzistuese.

Kjo certifikatë garanton që operatori:

- identifikon dhe vlerëson rreziqet në vendin e punës;
- merr masa parandaluese për aksidentet;
- pajis punonjësit me mjete mbrojtëse;
- zbaton procedura për emergjencat;
- respekton legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve gjatë realizimit të kontratës.

• **ISO 39001:2012 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Rrugore**

Gjatë punimeve përdoren automjete transporti, eskavatorë dhe mjete të tjera që ndikojnë në qarkullimin rrugor.

Kjo certifikatë garanton që operatori:

- planifikon dhe menaxhon sigurinë e qarkullimit gjatë punimeve;
- vendos sinjalistikën e përkohshme sipas standardeve;
- minimizon rrezikun e aksidenteve rrugore;
- organizon lëvizjen e mjeteve dhe personelit në mënyrë të sigurt;
- mbron përdoruesit e rrugës dhe punonjësit.

2.3.4 Ne përputhje me kërkesat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor ne specifikimet teknike dhe preventiv, per listen e artikujve, si me poshte:

- **Tuba HDPE**
- **Tuba PVC**
- **Rakorderi Gize (Saracineska, ajrues, reduktues, xhunto zmontimi, fllanxhe adaptor)**
- **Puseta shkarkimi**
- **Kapak gize**
- **Polisterol**
- **Hidroizolues**
- **Percjelles CU**
- **Rakorderi EF (Manikota, stafa PE)**
- **Matesat e ujit**
- **Rakorderi bronzi (kundravalvula, saracineska, nipple)**
- **Pompe dozimi**

Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve.

Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

- Të gjitha materialet e mësipërme duhet të plotësojnë standartet dhe kërkesat e kërkuara në specifikimet teknike ku te paraqiten certifikata/deshmi/deklarata konformiteti.

(Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe Nkontratës së bashkëpunimit të nënshkruar).

Shenim: Te gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Argumentimi: Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar, pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre, me qëllim realizimin e sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementët më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve Materiale hidraulike, Rakorderi dhe Tuba PE.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipërcituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributor për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit nën rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti kontraktor ka mundësi të kontaktojë me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pavarësi. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me Prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre. Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti Kontraktor ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standarte të kërkuara për mallra të planifikuara. Kjo siguron që mallra të ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike

2.3.5 Operatori Ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës si dhe punonjësit specialistë me certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën **40 (dyzet) punonjes** për periudhën **muajin e fundit** duke marrë si reference datën e hapjes së tenderit.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e mesiperme.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën **40 (dyzet) punonjes**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar në bazë të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për një periudhë të caktuar të zbatimit të punimeve numri i punonjësve duhet të jete mesatarisht të paktën **40 (dyzet) punonjes**. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistë i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre muajore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje

është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën **40 (dyzet) punonjes** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, I ndryshuar dhe akteve nenligjore.

ARGUMENTIMI I NUMRIT TE PUNONJESVE

Nga llogaritja e orëve të punës për të gjithë zërat e punimeve të preventivit sipas manualit të çmimeve për fuqinë punëtorë konkludojmë si mëposhtëm:

Total Dite pune punëtori = 484 dite pune

Dite pune gjithsej = 22 muaj (sipas grafikut të punimeve) * 22 dite/muaj * 8 ore pune dite
= 3872 ore pune,

Numri i fuqisë punëtorë = 154 880 ore pune / 3872 ore = 40 punëtorë/dite

Ne mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë punëtorë që kërkohej për realizimin e punimeve është minimumi 40 (dyzet) punonjes

b) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, **Drejtuesit Teknik, drejtues teknik në licencën e shoqërisë** të cilët të figurojnë në listëpagesa për muajin e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

Inxhinier Hidroteknik	1(nje)
Inxhinier Ndertimi	1(nje)
Inxhinier Gjeodet/ Markshnajder/ Gjeomatike	1 (nje)
Inxhinier Mekanik	1(nje)

Drejtuesit Teknik të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë, të figurojnë në listëpagesa për të paktën muajin e fundit, nga data e hapjes së tenderit, të kene kontrate pune të vlefshme.

Drejtuesit Teknik duhet të dorëzojnë dokumentacionin:

- Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate
- Diplomë profesionale
- CV
- Librezë pune

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të

kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

- c) Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera .
- d) Operatori Ekonomik për të realizuar objektin e prokurimit, duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë, **stafin inxhinierik** si më poshtë:
 - Inxhinier Elektrik 1 (nje)
 - Inxhinier Mjedis 1 (nje)

Për stafin e mësipërm inxhinierik duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate;
- Diplomë profesionale;
- Curriculum Vitae
- Librezë pune;

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

- e) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik, punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë, me profesione si më poshtë:

a) Staf Teknik

- 4 (kater) hidraulike
- 2 (dy) teknik ndertimi
- 2 (dy) punime në lartësi
- 4 (kater) punetore të thjeshtë
- 1 (nje) saldator
- 1 (nje) Hidroizolues
- 2 (dy) Suvatues
- 2 (dy) Murator
- 1 (nje) Murator dhe punim guri
- 2 (dy) Kaprentier
- 2 (dy) Hekurkthyes
- 1 (nje) Bojaxhi
- 1 (nje) Betonus
- 1 (nje) Pllakashtrus
- 2 (dy) Elektricitist
- 2 (dy) Konstrukione metalike
- 1 (nje) Teknik Mekanik

b) Punonjës Manovrator

- 3 (tre) Eskavatorist
- 1 (nje) Automakinist
- 2 (dy) Shofer

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Shënim: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar pika b) Punonjes manovrator ,të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë, në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalinprovuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të dryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, inxhinierik lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinieret në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjisllacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. ërkesa që operatori ekonomik të disponojë si personel kyç **Drejtues Teknik** të përbërë nga **1 Inxhinier Hidroteknik, 1 Inxhinier Ndërtimi, 1 Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Gjeomatikë dhe 1 Inxhinier Mekanik**, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të figurojnë në listëpagesat për muajin e fundit, është e lidhur ngushtë me natyrën dhe kompleksitetin e objektit “**Ndërtim ujësjellësi**”.

Ky staf është i domosdoshëm për të garantuar realizimin e punimeve sipas projektit, specifikimeve teknike dhe standardeve në fuqi, pasi:

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e elementeve hidraulike të rrjetit, dimensionimin dhe funksionimin e sistemit të furnizimit me ujë.

Inxhinieri i Ndërtimit mbikëqyr realizimin e punimeve civile, gërmimet, mbushjet, ndërtimin e strukturave dhe garanton zbatimin e projektit konstruktiv.

Inxhinieri Gjeodet/Markshajder/Gjeomatikë kryen piktetimin, matjet topografike, kontrollin e kuotave dhe pozicionimin e saktë të tubacioneve dhe objekteve sipas projektit.

Inxhinieri Mekanik mbikëqyr instalimin dhe funksionimin e pajisjeve mekanike, valvulave, pompave dhe elementëve të tjerë mekanikë të sistemit.

Kërkesa që këta drejtues teknikë të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë, të kenë kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesat e muajit të fundit synon të provojë se operatori ekonomik disponon realisht kapacitetet profesionale dhe njerëzore të nevojshme për zbatimin e kontratës, duke shmangur deklaratimet formale të personelit që nuk është efektivisht i angazhuar.

Kjo kërkesë është **proporcionale**, lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe mbështetet në **nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”**, si dhe në **VKM nr. 285, datë 19.05.2021**, të ndryshuar, të cilat i japin të drejtë autoritetit kontraktor të kërkojë personelin kryesor dhe kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin me cilësi dhe siguri të kontratës.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë **1 (një) Inxhinier Elektrik** dhe **1 (një) Inxhinier Mjedisi/Trajtim Ujërash** është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e objektit “**Ndërtim ujësjellësi**” dhe është e nevojshme për realizimin cilësor, të sigurt dhe në përputhje me projektin dhe legjislacionin në fuqi.

Inxhinieri Elektrik është i domosdoshëm për mbikëqyrjen dhe realizimin e punimeve elektrike që lidhen me furnizimin me energji të stacioneve të pompimit, paneleve elektrike, kablllove, sistemeve të komandimit dhe automatizimit, si dhe për kryerjen e provave dhe vënien në funksion të instalimeve elektrike. Prania e tij garanton që instalimet elektrike të realizohen sipas standardeve teknike dhe të sigurisë.

Inxhinieri i Mjedisit është i nevojshëm për të monitoruar respektimin e kërkesave mjedisore gjatë zbatimit të punimeve, menaxhimit të mbetjeve të ndërtimit, mbrojtjes së burimeve ujore dhe zbatimit të masave të parashikuara në aktet mjedisore dhe projekt. Gjithashtu, ai garanton që ndërhyrjet në rrjetin e furnizimit me ujë të mos shkaktojnë ndikime negative në mjedis dhe të respektojnë standardet për mbrojtjen e cilësisë së ujit.

Kërkesa për paraqitjen e **kontratës së punës, diplomës, CV-së dhe librezës së punës** synon të provojë se operatori ekonomik disponon realisht personelin e kualifikuar dhe me eksperiencën e nevojshme për realizimin e kontratës, duke shmangur deklaratimet formale të stafit.

Kjo kërkesë është **proporcionale**, lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe mbështetet në **nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”**, si dhe në **nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021**, të ndryshuar, të cilat i japin të drejtë autoritetit kontraktor të kërkojë kapacitetet profesionale dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

Kërkesa për disponimin e stafit teknik (hidraulikë, teknik ndërtimi, punonjës për punime në lartësi, saldator, hidroizolues, suvatues, muratorë, murator guri, karpentierë, hekurkthyes, bojaxhi, betonues, pllakashtrues, elektricistë, punonjës të konstruksioneve metalike dhe teknik mekanik) është e domosdoshme pasi punimet e ndërtimit të një ujësjellësi përfshijnë një gamë të gjerë procesesh civile, mekanike, elektrike dhe hidraulike.

Ky staf është i nevojshëm për:

realizimin e gërmimeve, shtrimit dhe montimit të tubacioneve;

ndërtimin e pusetave, rezervuarëve dhe strukturave prej betoni;

montimin e pajisjeve hidromekanike dhe elektrike;

saldimin dhe lidhjen e tubacioneve dhe elementëve metalikë;

kryerjen e hidroizolimeve, suvatimeve dhe punimeve të restaurimit pas gërmimeve;

garantimin e sigurisë gjatë punimeve në lartësi dhe në kantier;

realizimin e punimeve sipas afateve dhe standardeve teknike të projektit.

Numri dhe profilet e kërkuara janë përcaktuar në funksion të volumit, kompleksitetit dhe natyrës së punimeve dhe janë në përputhje me kërkesat e projektit të zbatimit, duke garantuar që operatori ekonomik të ketë kapacitetet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës me cilësi, siguri dhe brenda afateve të përcaktuara. Kjo kërkesë është në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021, të ndryshuar.

f) Operatori Ekonomik duhet te kete të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome universitare, dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, punonjësit si më poshtë:

-1 (nje) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave ose me kontrate pune te vlefshme. **(si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes se tenderit, ose nepermjet kontraktimit)**

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga i gjithë bashkimi ne perputhje me perqindjen dhe /ose natyren e pjesemarjes ne pune, te percaktuar me aktmarreveshje.

-1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", te pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH. **(edhe nepermjet kontraktimit)**

- Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar mjekun e shoqerise ose mjek te kontraktuar nga jashte me kontrate sherbimi / me subjekte te specializuara per kete qellim. Mjeket te jene te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga i gjithë bashkimi ne perputhje me perqindjen dhe /ose natyren e pjesemarjes ne pune, te percaktuar me aktmarreveshje.

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe Ligjit nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentet përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", te pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

-si dhe mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këto qëllime. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë për të siguruar garancinë e ecurisë e punimeve.

2.3.6. Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose më e qara të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

<i>Nr</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 -20 ton	2 Cope	Ne funksion të volumit të materialeve që do të transportohen kapacitetit ditor të germimeve /ngarkimeve sipas kërkesave të grafikut të zbatimit të punimeve.
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	2 Cope	Ne funksion të volumit të materialeve që do të transportohen kapacitetit ditor të germimeve /ngarkimeve sipas kërkesave të grafikut të zbatimit të punimeve.
3	Kamion me vinc	2 Cope	Ne funksion të volumit të punimeve kryen paralelisht procesin e transportit dhe ngritjes së pajisjeve
4	Ekskavator me zinxhire me peshe jo më të vogël se 20 ton	1 Cope	Pronësi ose me qara
5	Eskavator me goma me targa	1 Cope	Pronësi ose me qara
6	Minieskavator	2 Cope	Ne funksion të natyrës së punimeve të ujësjetës ku parashikohen punime në hapësira të kufizuara,pranë objekteve ekzistuese, rrugëve ,mureve mbajtëse etj.
7	Kamionçinë	1 Cope	Pronësi ose me qara
8	Fadrome	1 Copë	Pronësi ose me qara
9	Minifadrome	1 Cope	Pronësi ose me qara
10	Autobot uji	1 Cope	Pronësi ose me qara
11	Dumper vetëshkarkues me peshe jo më të vogël se 2.5 ton me targa	2 Cope	Transport të materialeve të germimit materialeve mbushes agregateve ,rres ,pajisja me targa mundeson qarkullimin e ligjshëm në rrugët publike
12	Rimorkiator për levizjen e makinerive të ndërtimit me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton	1 Cope	Pronësi ose me qara
13	Vibrator të jashtëm betoni	5 Cope	Pajisjet janë të nevojshme për ngjeshjen dhe kompaktimin e betonit në elemente ku përdorimi i vib. të brendshëm nuk është i përshtatshëm ose nuk siguron rezultatin e kërkuar duke eliminuar fluskat dhe boshllëqet e ajrit dhe rrit rezistencën dhe cilësinë e tij .
14	Vibrator brendshëm betoni	2 Cope	Pajisjet janë të nevojshme për ngjeshjen dhe kompaktimin e betonit rrit rezistencën dhe cilësinë e tij .
15	Matrapik me benzine	2 Cope	Pajisja është e nevojshme për prishjen e shtresave të betonit asfaltit gureve dhe formacioneve të forta gjatë hapjes së traseve të tubacioneve dhe në pika ku përdorimi i makinerive të renda nuk është i mundur.

16	Gjenerator / Motogjenerator	1 Cope	Pronësi ose me qera
17	Pllake ngjeshëse me vibrim (min 700 kg)	1 Cope	Pronësi ose me qera
18	Saldatrice	1 Cope	Pronësi ose me qera
19	Makineri ngjeshese apo kompaktuese (Tokmak)	2 Cope	Ngjeshjen e e shtresave te mbushjes se kanaleve te tubacioneve rreth pusetave dhomave te valvulave dhe ne zona me hapësire te kufizuar.
20	Kompresor	1 Cope	Pronësi ose me qera
21	Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	1 Cope	Pronësi ose me qera
22	Aparat saldimi për ngjitje të tubave koke me koke	1 Cope	Pronësi ose me qera
23	Makine per shpime horizontale te drejtuara (HDD)	1 Cope	Pronësi ose me qera
24	Palankola	10 Cope	Terreni paraqet rrezikshmeri shembjeje ne germime me thellesi te konsiderueshme ne perputhje me gjatesine dhe menyren e mbeshtetjes se germimeve .
25	Trench Box	5 Cope	Nevoja per zbatimin e masave te sigurise ne pune gjate germimeve vecanerisht ne kanale ku ekziston rreziku i shembjes se dherave .
26	Instrument Topografik (Stacion Total, GPS)	1 Cope	Pronësi ose me qera
27	Vibrator hidraulik me force vibruese jo me pak se 464 Kn	1 Cope	Pronësi ose me qera
28	Pompe uji	1 Cope	Pronësi ose me qera
29	Kalleperi (betoforma)	1000m2	Per volum te madh te punimeve prej betoni si puseta kontrolli,dhoma valvulash,bloqe ankorimi themele dhe struktura te tjera mbeshtetese realizimin e njekohshem te disa fronteve te betonimit.
30	Autobetoniere	2 Cope	Ne baze te volumit te betonimeve,shperndarjes e fronteve te punes dhe nevojës per furnizim te vazhdueshem me beton .
31	Autopompe	1 Cope	Pronësi ose me qera
32	Betoniere kantieri	1 Cope	Pronësi ose me qera
33	Dedektor rrjetesh	1 Cope	Pronësi ose me qera
34	Automjet teknologjik per inspektimin e tubave e pajisur me dy ose me shume sisteme kamerash	1 Cope	Pronësi ose me qera
35	Pajisje digjitale e levizshme per matjen e rrjedhjes/prurjes	1 Cope	Pronësi ose me qera
36	Pajsje per testimin e tubavce	1 Cope	Pronësi ose me qera

- Kokore + Jeleke fosforeshente minimumi 40 cope
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

- Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë sigurimi); te vlefshme.

Për mjetet me qera, të paraqiten dokumentet e mesiperme që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë sigurimi); te vlefshme dhe keto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë noteriale të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes / faturë tatimore / dokument zhdoganimi të mjetit. Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shitblerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme. Për pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Përcaktimi i mjeteve dhe pajisjeve në këtë procedurë është kryer mbi bazën e volumeve të punimeve të preventivuara dhe natyrës së proceseve të zbatimit të projektit, me qëllim garantimin e realizimit të punimeve brenda afateve, sipas specifikimeve teknike dhe standardeve të sigurisë në fuqi. Konkretisht:

Mjetet kamiona vetëshkarkues, kamioncina dhe dumper janë kërkuar për transportin e dherave apo materialeve që do të dalin gjatë zbatimit të punimeve, si dhe për transportimin materialeve, rakorderive që do të furnizohen me qëllim realizimin e veprës. Për transportin e materialeve të ndërtimit brenda dhe jashtë kantierit sipas nevojave të punës dhe sasisë, tipologjitë e materialeve që do të transportohen nevojiten kamiona vetëshkarkues dhe kamioncina me kapacitet mbajtës të ndryshëm. Ky numër është i nevojshëm në raport edhe me vëllimin e materialeve.

Mjetet eskavator me goma, eskavator me zinxhir, minieskavator, fadrome dhe minifadrome janë kërkuar për punimet si gërmime kanalesh, gërmime dheu, sistemime, etj gjatë zbatimit të projekt preventivit. Gjatë procesit të punës për zbatimin e punimeve të gërmimeve të dheut, nevojitet përdorimi i eskavatorëve për secilin vëllim të objektit që do të ndërtohet.

Në preventiv janë parashikuar punime shtresash, ndaj janë kërkuar makineri ngjeshese apo kompaktuese dhe pllake ngjeshese me vibrim. Kërkesa për makineri të tillë është bërë pasi në preventiv janë parashikuar edhe punime në nenshtrese zhavori, ngjeshje dheu te germuar etj.

Autobetoniere, autopompe dhe betoniere, janë kërkuar për realizimin e punimeve që kanë të bëjnë me betonin dhe beton arme me qëllim ruajtjen e markës së betonit sipas specifikimeve teknike. Duke qenë se transportimi i betonit,

kërkon procese dhe makineri specifike siç është autobetonierja, nisur nga sasia e punimeve të betonit dhe betonarmesë në preventiv.

Trench Box, janë kerkuar për realizimin e punimeve mbi mbrojtjen e punonjesve gjatë realizimit të punimeve mbi hapjen e kanaleve për shtrimin e tubave.

Makine për shpime horizontale të drejtuara (HDD) është kerkuar pasi do të perdoret për kalimin e tubave të celikut për të realizuar projektin.

Aparat saldimi për ngjitje të tubave koke me koke, aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën Elektro Fusion, Pajisje për testimin e tubave, pajisje digjitale e levizshme për matjen e rrjedhjes/prurjes, pajisje për testimin e tubave janë kerkuar për realizimin e punimeve mbi të linjave të tubacioneve të furnizimit me ujë. Palankolat janë kerkuar për realizimin e punimeve mbi mbrojtjen e punonjesve gjatë realizimit të pusëve të linjes së shpërndarjes së ujesjellsit. dhe Vibrator hidraulik me forcë vibruese jo më pak se 464 Kn është kerkuar për tu përdorur për realizimin e vendosjes së palankolave. Automjet teknologjik për inspektimin e tubave e pajisur me dy ose me shumë sisteme kamerash, dedektor rrjetesh shërbejnë për realizimin e inspektimit të tubave PE dhe linjave kabllorë elektrik.

Në lidhje me mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit janë kerkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier” dhe numrit të punonjesve të kerkuar në këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu, pajisjet e mbrojtjes në punë dhe fikëset e zjarrit janë kerkuar në zbatim të kërkesave të VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “i ndryshuar. Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së punonjesve gjatë ekzekutimit të punimeve.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Ky kriter përmbushet edhe nëpërmjet një kontratë noteriale shërbimi/bashkëpunimit të nënshkruar, për licencën e sipërcituar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar e bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji*”. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”. Në nenin 57/2 të ligjit 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit Nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri*”.

Ndërkohë, sipas VKM Nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” “*Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme*”

I. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, janë hartuar në përputhje me legjislacionin përkatës për ndërtimet civile dhe infrastrukturore dhe kanë për qëllim të sigurojnë cilësi të qëndrueshme, funksionalitet afatgjatë dhe siguri teknike të punimeve të parashikuara në rikonstrukcionin e rrugëve në njësitë administrative. Për shkak të veçorive të terrenit dhe kushteve klimatike të zonës, janë përfshirë elementë të detajuar. Këto specifikime janë proporcionale me objektin e kontratës, të zbatueshme në praktikë dhe janë hartuar me kujdes për të parandaluar keqzbatimin teknik, për të garantuar jetëgjatësinë e rrugës dhe për të krijuar kushte të sigurt qarkullimi për banorët e zonës.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Njesia e Prokurimit